REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

6124

Maliq më 23.10.2026

Projekt-Vendim - NR. 5
Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

I. Miratim fondi për familjet e mëposhtëme:

Nr.	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma /Lekë
1	Aurel Zyfi	H30430027M	Pojan	50.000
2	Pëllumb Dautllari	E30423040B	Pirg	50.000
3	Alush Zhupani	F40509123V	Maliq	20.000

II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2027, si më poshtë :

Gr.	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
00	10430	606	Fondi Social	120.000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social–Ekonomike të familjes.

Konceptoi Pergj.Sek I Politikave Sociale
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petrit

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë
Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Maliq më .10.2026

Relacion
Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve të mëposhtme rezultoi se:

1.Aurel Zyfi.

Z.Aurel Jashar Zyfi është banues në fshatin Kreshpanj, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq. Familja përbëhet nga katër anëtarë. Për shkak të problematikave familjare të krijuara ndër vite, bashkëshortja është larguar nga banesa së bashku me djalin e mitur, ndërkohë që procedurat e zgjidhjes së martesës nuk ishin përfunduar. Aktualisht, shtetasi Aurel Jashar Zyfi jeton në banesë së bashku me djalin e tij, ndërsa dy vajzat jetojnë të ndara nga familja, njëra prej të cilave ndodhet pranë Fondacionit Kenedi në Korçë, ndërsa tjetra banon në qytetin e Korçës. Djali që jeton me të atin largohet herë pas here në emigracion, me qëllim sigurimin e të ardhurave për të përballuar nevojat e tij dhe të familjes, por këto të ardhura janë të pasigurta dhe nuk garantojnë stabilitet ekonomik.Një tjetër problematikë e rëndësishme lidhet me gjendjen shëndetësore të kryefamiljarit, i cili vuan nga disa probleme shëndetësore. Edhe kushtet e banimit paraqiten tejet të vështira. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

2.Pëllumb Dautllari.

Z.Pëllumb Dautllari është banor I fshatit Sovjan,Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq.Familja përbëhet nga dy anëtarë zoti Pëllumb dhe bashkëshortja e tij të dy pensionistë, kryefamiljari përfiton pension minimal pleqërie, ndërsa bashkëshortja pension social, të ardhura të cilat nuk mjaftojnë për përballimin e nevojave bazë të jetesës dhe shpenzimeve mjekësore. Çifti i të moshuarve jeton në një banesë tejet të amortizuar dhe përballet me vështirësi të shumta ekonomike dhe shëndetësore. Për shkak të pamundësive financiare dhe problematikave me detyrimet e energjisë elektrike, që prej fillimit të muajit tetor, atyre u është ndërprerë furnizimi me energji elektrike, duke rënduar më tej kushtet e jetesës. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit

Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

3.Alush Zhupani.

Z.Alush Shaban Zhupani është banor i qytetit Maliq, Bashkia Maliq. Familja Zhupani përbëhet nga dy anëtarë zoti Alush dhe bashkëshortja e tij Nefaret të dy pensionistë. Zoti Alush prej shumë vitesh vuan nga disa sëmundje të cilat kanë nevojë për mjekime të shumta dhe vizita të shpeshta. Çifti i të moshuarve përballet me vështirësi të shumta ekonomike dhe shëndetësore. Këto nevoja shoqërohen me shpenzime të vazhdueshme për barna, vizita, analiza dhe nevoja të tjera shëndetësore, duke rënduar më tej buxhetin e familjes. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

Konceptoi Pergj.Sek I Politikave Sociale
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petriti

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ